

RRJETI PËR ZHVILLIM RURAL I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



e-buletini
no. 12
Janar - Korrik 2016

www.ruralnet.mk

PUBLIKON

Rrjeti për zhvillim rural i
Republikës së Maqedonisë

"Kosta Veselinov" 3a,
1000 Skopje
R. e Maqedonisë
T: +389 (2) 3075 506
F: +389 (2) 3075 503
email: info@ruralnet.mk



Në këtë numër...



1 Institut për Zhvillim të Komunitetit - Tetovë
faqe 3 Aktivitete për zhvillim rural

2 Aktivitete të realizuara të Fondacionit
faqe 4 Elena Luka

3 Ekipi i CeProSARD ka përpiluar Regjistrin për
faqe 5 Potenciale të Turizmit Rural për Rajonin e Pollogut të Planifikimit

4 Aktivitete të zbatuar nga
faqe 6 POLIMAT 13 – anëtar i RZR i RM

5 Arritje të Organizatës së Grave
faqe 8 “Cvet” nga Krusheva

6 Aktivitete për ngritjen e kapacitetit
faqe 9 me anë të Mekanizmit të Projektit

7 Zhvillohet Konferenca e parë kombëtare
faqe 11 për ndryshimet klimatike dhe bujqësia maqedonase

8 Përgatitet video për adaptim të bujqësisë
faqe 13 ndaj ndryshimeve klimatike

9 Ngritja e vetëdijes publike për sëmundjen
faqe 13 lëkurë me kokla tek lopët qumështore

10 Publikohet video materiale për vetëdije publike
faqe 15 për historitë e suksesit të projektit

11 Qasja EU LEADER i promovuar në Rajonin
faqe 15 Lindor dhe Juglindor të Planifikimit të Republikës së Maqedonisë

12 Zhvillohet Kuvendi i Parë Gjeneral i
faqe 17 PREPARE AISBL

13 Bashkëpunim me RBZR për zbatimin e
faqe 18 projektit ALTER
(Territore Lokale Aktive për Zhvillim Ekonomik në Mjediset Rurale) financuar nga BE

14 Vizita e ELARD në Maqedoni
faqe 18

15 ELARD kremton presidencën e re
faqe 20 për periudhën 2016-2017
Qytetarja estoniane Kristiina Tammets është zgjedhur femra e parë
presidence e ELARD (Asociacioni Evropian LEADER për Zhvillim Rural)





1

Institut për Zhvillim të Komunitetit - Tetovë

Aktivite për zhvillim rural

Panairi i mjaftit dhe produkte bletare

Shoqata IZK – Tetovë, në bashkëpunim dhe mbështetjen e SWG dhe programit ABDA dhe Shoqatës Ekologjike Maqedonase, me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit ndërkufitar mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës në rajonin e Malit Sharr, si dhe të promovojë zhvillim rural dhe prodhimtari të ushqimit, ka organizuar Panair të Malit Sharr për mjaltë dhe produkte bletare. Panairi u zhvillua më 23 prill 2016 me fillim në orën 11.00 në restorantin Antonio, Jegunovce. Panairi ishte shoqëruar me tribunë për bashkëpunim ndërkufitar dhe zhvillim rural që ka mundësuar të shkëmbehen mendime dhe përvoja për prodhimtarinë e mjaltit, produkteve bletare dhe zhvillim rural.

Si rezultat është hartuar një katalog i prodhuesve të mjaltit, në të cilën janë shfaqur emri i prodhuesit, detaje për kontakt dhe informacione tjera. Pjesëmarrëse të panairit të mjaltit ju ishte dhënë pllakate dhe falënderime për pjesëmarrje.

Më tepër për panairin e mjaltit dhe produktet bletare, fotografi dhe e-katalogun e prodhuesve të mjaltit mund të gjeni në ueb faqen e IZK - Tetovë: www.irz.org.mk.



Formimi i Grupit Lokal të Aksionit GLA Skardus

IZK - Tetovë në kuadër të aktiviteteve programore punon në zhvillimin e potencialeve lokale, përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit dhe zhvillimit rural. Në rrjedhë është formimi i grupit lokal të aksionit GLA në territorin e komunave Jegunovce dhe Tearcë.

Në bazë të bisedave paraprake për formim të grupit lokal të aksionit GLA në rajonin e komunës së Jegunovce, Tearcë dhe Tetovë, dhe në bazë të ligjit për shoqata dhe fondacione (Gazeta Zyrtare 52/10), më 27 korrik 2016 në hapësirat e komunës Jegunovce u zhvillua Kuvendi Themelues i Grupit Lokal të Aksionit GLA SKARDUS Tearcë – Jegunovcë.

Shoqata për Zhvillim Rural Grupi Lokal i Aksionit – GLA Skardus është shoqatë vullnetare, jorprofitaibile, joqeveritare, jopartiake e themeluar me shoqërim të lehtë, që është iniciator, shtytës dhe krijues në mobilizimin e potencialeve lokale me anë të organizimit, arsimit dhe mbështetjes për përmirësimin e kushteve të jetës dhe zhvillimit të plotë të mjedisit rural në territorin e komunave Tearcë dhe Jegunovcë.

Shoqata IZK-Tetovë është në mënyrë aktive e kyçur në formimin e GLA Skardus si anëtar i trupit koordinues, dhe mundëson mbështetje administrative dhe teknike.





2

Aktivitete të realizuara të Fondacionit Elena Luka

Në kuadër të **Programit për avancimin e kushteve për rritje cilësore dhe zhvillim të fëmijëve dhe të rinjve**, Fondacioni Elena Luka ka realizuar projektin “Planifiko ardhmërinë tënde” dhe ka dhënë pesë bursa për shkollë të mesme për pesë vajza nga pjesët vijuese rurale: Lozovo, Mogila, Centar Zhupa, Çashka dhe Shkup. Të drejtë burse kanë realizuar kandidatet që kanë plotësuar kriteret që kanë përshkruar në konkursin e dhe gjatë përcaktimit të kandidatëve ishin marrë parasysh suksesi i nxënësve dhe të ardhurat mujore të familjes. Në periudhën vijuese Fondacioni do të shpërndajë edhe pesë bursa për studente që vijnë nga komunat rurale.

Në kuadër të **Programit për avancimin e pozitës socio-ekonomike të grave dhe të rinjve**, Fondacioni Elena Luka ka realizuar projektin “Përforcimi ekonomik i nënave vejane me anë të mbështetjes teknike dhe trajnime”. Në kuadër të këtij projekti Fondacioni Elena Luka ka mbështetur gjashtë nëna vejane për të filluar biznes ose të zgjerojnë biznesin aktual. Për çdo nënë vejane ishte siguruar mbështetje financiare për furnizim të pajisjes teknike, materiale për punë ose trajnim në shumë prej 100.000 denarë.

Gjithashtu, në kuadër të këtij programi, Fondacioni Elena Luka në bashkëpunim me shtëpinë e modës me



renome Elena Luka, për pesë gra dhe vajza ka siguruar pesë trajnime për dizajnues, modelime, punë me dorë dhe rrobaqepëse.

Më 8 korrik 2016, Fondacioni Elena Luka ka organizuar takim me gratë sipërmarrëse. Më tepër se 20 sipërmarrës potencial dhe sipërmarrës prej gjithsej 12 qyteteve të ndryshme në Maqedoni, kanë pasur mundësinë të njoftohen me z-nj Elena Pandeva, një grua e suksesshme në biznes dhe sipërmarrje. Ata kanë pasur mundësi të dëgjojnë përvojat e z-nj Elena Pandeva që pa hamendje ka shpërndarë me ata këshilla të shumtë nga puna e deritanishme.

Më 29 korrik 2016 Fondacioni Elena

Luka ka pasur takim me gratë e komune Centar Zhupa. Gjegjësisht, Dejan Sidorovski, drejtor kreativ i Shtëpisë së Modës Elena Luka dhe Natasha Koceva Arsovska, modelues dhe person përgjegjës në Sektorin për Prodhimtari u takuan me gratë e komunës së Centar Zhupa. Ata kanë pasur mundësi të shohin përpunimet e grave nga Centar Zhupa dhe të merren vesh për mundësitë e bashkëpunimit të mëtejshëm.

Fondacioni Elena Luka në kuadër të **Programit për parandalimin e gjitha formave të dhunës mbi gratë** ka zbatuar edukime me të rinjtë për të njoftuar me konceptet e gjinisë dhe zhvillimit, jo-diskriminim dhe dhuna e bazuar në dhunë.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve, në periudhën janar – korrik 2016 u zbatuan 18 trajnime me rreth 400 të rinj të temat vijuese: gjinia dhe barazia gjinore, parandalim të diskriminimit dhe parandalim të dhunës së bazuar në gjini.

Në edukimet janë përfshirë edhe nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët, ndërsa trajnimet janë zbatuar në qytetet vijuese: Shkup, Veles, Pehçevë, Kumanovë dhe Berovë.





3

Ekipi i CeProSARD ka përpiluar Regjistrin për Potenciale të Turizmit Rural për Rajonin e Pollogut të Planifikimit



Qendra për promovim të praktikave bujqësore dhe zhvillim rural – CeProSARD për nevojat e Qendrës për Zhvillim të Rajonit të Pollogut të Planifikimit – QZRPP në pjesën e parë të vitit 2016 ka përpiluar “Regjistrin për Potenciale të Turizmit Rural për Rajonin e Pollogut të Planifikimit”.

Regjistri ishte hartuar në kuadër të projektit “Zgjidhje inovative për qasje më të mirë në shërbime të nivelit lokal”

të zbatuar nga UNDP në bashkëpunim me Ministrinë për Vetëqeverisje Lokale (MVL). Qëllimi i këtij projekti është të mundësojë MVL-së të avancojë kapacitetet për promovim të menaxhimit lokal të drejtuar për qytetarin.

Ekipi i CeProSARD ka bërë një hulumtim dhe ka vizituar komunat e rajonit. Në kuadër të aktiviteteve të këtij projekti ishin zhvilluar punëtori konsultimi në hapësirat e Qendrës për Zhvil-

lim të Rajonit të Pollogut të Planifikimit dhe në komunën Gostivar. Në takimet pjesëmarrje aktive kanë marrë përfaqësues të komunave, sektorit afarist – pronarë të hoteleve, restorante, agjenci turistike, shoqëri malore, organizata joqeveritare dhe aktorë tjerë përkatës që veprojnë në fushën e turizmit rural në rajonin e Pollogut të planifikimit.





4

Aktivitete të zbatuar nga POLIMAT 13 – anëtar i RZR i RM

- Shoqata për zhvillim, arsim dhe etikë ekologjike POLIMAT 13 nga Bogdanci në bashkëpunim me Shoqatën Ekologjike Maqedonase (MED) nga Shkupi, në vitin 2016 ka filluar me zbatimin e aktiviteteve lidhur me promovimin e diversitetit bimor në rajonin e rëndësishëm bimor “Bogdanci” dhe monitorim të llojit endemik të bimës *Astaragalus physocalyx*, vendbanimin, popullsia dhe kërcënimet potenciale.

Astaragalus physocalyx që është i pranishëm në ZRP “Bogdanci” është nën-endemit që përmendet si i kërcënuar në listën ndërkombëtare të Unionit Botëror për Mbrojtje të Natyrës (IUCN). Në Maqedoni thjeshtë takohet në rrethinën e Bogdancit në malet përkatëse. Përveç në Maqedoni ky lloj i rëndësishëm takohet edhe në Bullgari dhe Turqi. POLIMAT 13 ka realizuar prezantime në shkollat fillore të komunës, ndërsa me nxënësit e shkollave të mesme ka realizuar shëtitje arsimore në vendet ku gjendet *Astaragalus hysocalyx*.



Më 6 qershor për vizitë në POLIMAT 13 në Bogdanci ishte Ivis Çan, përfaqësues i Plantlife nga Britania e Madhe. Qëllimi i vizitës ishte mbikëqyrja në teren të rajonit të rëndësishëm bimor “Bogdanci” dhe prezantim të aktiviteteve për mbrojtje të llojeve kryesore të bimëve dhe afirmim të diversitetit bimor në të cilin janë zbatuar. Udhëheqës të projektit në nivelin ndërkombëtar janë Plantlife, organizatë joqeveritare nga Britania e Madhe dhe Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtje të Natyrës (IUCN). Udhëheqës kombëtar për Maqedoninë është Shoqata Ekologjike Maqedonase, ndërsa POLIMAT 13 është partner lokal dhe përgjegjës për aktivitetet që zhvillohen në ZRP “Bogdanci”.

- Ngjashëm me vitin e kaluar, edhe këtë vit POLIMAT 13 realizon takime me banorët e komunës së Bogdancit me qëllim të nxitjes së qytetarëve për aktivitete që do të kontribuonin për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe motivim për kujdes të komunitetit. Këto takime përfshijnë tema të ndryshme: mapim në komunitet; disa

tema nga perma-kultura – mënyra dhe përfitimi i përgatitjeve të kompostove; ndërtime nga materiale natyrore; dhe uji i shiut – mënyra e mbledhjes dhe përdorimi.

- Më 19 mars, në parkun e qytetit në Bogdanci në organizim të POLIMAT 13 ishte shënuar iniciativa globale Ora e Plantit Tokë, me çfarë Bogdanci u gjet në hartën e qyteteve që me fikjen e dritave ishte dërguar një mesazh për shpëtimin e planetit Tokë. Kontributin e tyre kanë pasur edhe nxënësit e shkollës së mesme “Bogdanci”. Pjesëmarrje kanë pasur edhe korri dhe orkestra pranë kësaj shkolle, si dhe akte të individëve: lexim të prozës dhe paraqitje muzikore.





- Takimi i fundit i grupeve të punës nga procesi i Agjendës së Gjelbër në kuadër të projektit të USAID Strategji Komunale për Ndryshime Klimatike ishte zhvilluar më 28 prill. Me këtë takim që u mbajt në vendin që gjendet rezervuari i ri i ujit të pijshëm janë përmbledhur aktivitetet që zbatohen në periudhën e kaluar. Me rezervuarin e ri të ndërtuar me kapacitet prej 500 m³ do të përmirësohet furnizimi i ujit dhe do të mundësohet menaxhim më efikas me sistemin e furnizimit të ujit, që si rezultat do të kontribuojë për kursimin e energjisë. Projekti i USAID Strategji Komunale për Ndryshime Klimatike zbatohet nga Milieukontakt Maqedoni në partneritet me komunën Bogdanci, Rrjetin për Zhvillim Rural i RM dhe POLIMAT 13.

- Prej 17-19 qershor, POLIMAT 13 ka marrë pjesë në punëtorinë e parë të përbashkët në kuadër të IPA projektit "Organizata të përforcuara qytetare për transponim pjesëmarrës dhe zbatim të pakos EU 2020 për energji dhe



klime" që zbatohet nga Milieukontakt Maqedoni në partneritet me institutin për trajnim Kocka dhe Front 21/42. Në këtë punëtori, përveç POLIMAT 13 kanë marrë pjesë edhe nëntë organizata qytetare që marrin pjesë si organizata partnere. Qëllimi kryesor i projektit është përmirësim i menaxhimit me mjedisin jetësor me anë të krijimit të kushteve për pjesëmarrje efektive të

organizatave qytetare në procesin e marrjes së vendimeve.

- Në muajin qershor POLIMAT 13 në partneritet me AGRO-VINKA si organizata anëtare të RZR kanë përfunduar realizimin e iniciativës së projektit "Bëhu bletar!" që ishte mbështetur nga Projekti i USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike që zbatohet nga Rrjeti për Zhvillim Rural të RM. Me disa aktivitete të kësaj iniciative ishte nxitur bashkëpunimi mes bletarëve nga komunat e Bogdancit dhe Vinicës me qëllim të afirmimit të potencialeve dhe përdorimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore për zhvillim të bletarisë.





5

Arritje të Organizatës së Grave “Cvet” nga Krusheva

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 gratë e organizatës “Cvet” kanë realizuar aktivitete të shumtë në Krushevë dhe viset rurale përreth.

Në janar, me mbështetjen e një donatori, ju kanë dhuruar pako për vitin e ri fëmijëve të pjesëve rurale përreth qytetit: f. Aldanci, f. Norov, f. Buçin, f. Presil dhe tjera. Ngjarja ishte plotësuar me shfaqje të fëmijëve në gjitha fshatrat në të cilat janë shpërndarë pakot.

Muajin e njëjtë e kanë festuar festën Vasilica me ngjarje humanitare, të plotësuar me ngjarje fetare.

Në mënyrë tradicionale ishte festuar dita e gruas 8 marsi dhe ishte organizuar një shfaqje mode në të cilën OG “Cvet” ka prezantuar produktet e reja.

Më 15 mars kanë filluar me përpunimin e kostumeve të dizajnuar për plazh, të synuar për një kompani në Greqi me të cilën kanë firmosur marrëveshje. Produktet i kanë përpunuar anëtarët e reja të organizatës me mbështetje dhe këshilla të anëtarëve me përvojë të “Cvet”.

Ne periudhën e njëjtë janë përpunuar edhe vepra artizane për nevojat e Etno Panairit që ishte zhvilluar në qershor 2016 në Krushevë.





6

Aktivitete për ngritjen e kapacitetit me anë të Mekanizmit të Projektit

RZR ka vazhduar me zbatimin e Mekanizmit të Projektit që ka për qëllim të rrit dhe përforcojë kapacitetet e organizatave anëtare të RZR në lidhje me praktikën për menaxhimin me projekte.

Pas pranimit të 17 aplikimeve për projekte afatshkurtër, Organi Administrativ, i përbërë nga përfaqësues të organizatave të RZR, kanë zhvilluar dy takime në prill dhe kanë bërë një vlerësim të gjitha aplikimeve në dy nivele: kompetenca teknike (paraqitja e gjitha dokumenteve të nevojshme) dhe kompetenca e përmbytjes. Organi Administrativ ka prezantuar zbulimet e vlerësimit para Autoritetit Menaxhues që ka bërë zgjedhjen përfundimtare të 7 aplikimeve për projekt. Lista e projekteve të zgjedhura ishte publikuar në ueb faqen e RZR dhe ish-in firmosur Memorandume të Bashkëpunimit mes RZR dhe aplikantët e zgjedhur në fund të muajit prill.

Zbatimi i shtatë iniciativave të projektit të zgjedhur në kuadër të Thirrjes së 3-të për Mbështetje të Iniciativave të Projektit të organizatave anëtare të RZR të shpallur me anë të Mekanizmit të Projektit të RZR, ka filluar më 1 maj 2016. Duke dhënë karakterin e llojllojshëm të projekteve dhe orarit të realizimit të tyre, RZR ka mundësuar një orar kohor të lehtë për zbatim. RZR ka



dhënë një mandat prej 6 muajve për 14 organizatave anëtare për realizimin e iniciativave të projektit më poshtë:

1. **“Bëhu bletar!”**
2. **“Rruga magjike e prodhimitarisë organike”**
3. **“Edukim dhe mbështetje të bletarëve të rinj në rajonin e Strugës BLETARIA – BIZNIS FITIMPRURËS”**
4. **“Edukim i prodhuesve bujqësor për mbrojtje të mjedisit jetësor nga përdorimi i tepërt i plehrave mineral dhe pesticide”**
5. **“Specialitete tradicionale nga Malesheva”**
6. **“Zjarret malore dhe ndikimi i tyre mbi zhvillimin rural dhe ndryshimet klimatike”**
7. **“Mjedis jetësor më të mirë”**

Gjatë qershorit dhe korrikut, organizatat zbatuese kanë raportuar për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të projektit:

- Organizatat partnere “Agro Vinka” dhe “Polomath 13” kanë organizuar trajnime për afirmimin dhe zhvillimin e bletarisë që ka përfshirë vizita në teren të komuniteteve bletare dhe bletarët kanë pasur mundësinë të shkëmbejnë përvoja dhe të krahasojnë metoda të ndryshme të kultivimit të bletëve. Trajnimet, e organizuar në kuadër të iniciativës së projektit “Bëhu bletar!”, ka grumbulluar pjesëmarrës nga komunat e Bogdancit dhe Vinicës. Një trajnues me përvojë ka transferuar njohuritë për planifikimin, organizimin dhe menaxhimin e komuniteteve bletare dhe ka sqaruar mënyrat e ndryshme për të përmirësuar procedurat teknologjike për rritje të rendimentit dhe për të zvogëluar rreziqet e zvogëlimit të rendimentit dhe numrin e komuniteteve produktive të bletëve.

- “Rruga magjike e prodhimitarisë organike”, në Qershor, ka mbledhur fer-





merët e fshatrave Novo Sellë, Drazhevë, Konjarevë dhe Gaborovë për të vizituar fermat organike për kivi dhe aroni. Pastaj, më vonë, në korrik, kjo iniciativë e projektit ka organizuar një vizitë tjetër, këtë herë në Vinicë, ku vizitorët kanë pasur mundësinë të informohen dhe të shkëmbejnë eksperiencën lidhur me bletarinë organike, por edhe të përfitojnë njohuri për joxhi ferrat, një kulturë që është e re për rajonin tonë dhe kërkon një trajnim më specifik gjatë kultivimit.

“Rruga magjike e prodhimtarisë organike” zbatohet nga Shoqata e Prodhuesve të Bimëve dhe Luleve “HORTI EKO” dhe Shoqata e Fermerëve Gra “AGRO – VINKA”.

- Projekti “BLETARIA – BIZNIS FIT-IMPRURËS” ka përfunduar aktivitetet me ngjarjen promovuese ku ishin prezantuar broshura dhe video materiali për procesin e bletarisë në rajonin e Strugës. Shoqata Qendra Kreative “RURBANKULT” dhe Shoqata e Bletarëve “MATICA”, me anë të aktiviteteve të synuar për edukimin dhe mbështetjen e bletarëve të rinj të rajonit të Strugës. Qëllimi përfundimtar ishte të zmadhojë numrin e bletarëve si dhe cilësinë dhe sasinë e potencialit prodhues të mjaltit dhe produkteve të mjaltit.

- Rreth tridhjetë receta të specialiteteve të ushqimit lokal, të zhvilluar në broshurë me emrin “Specialitete tradicionale të rajonit të Malishevës”, ishin promovuar më 13 qershor 2016, në etno panairin tradicional “Kremtimi i Ditës së Shën Palit në Pehçevë”. Vizitorët nga vendi dhe nga Bullgaria fqinje kishin mundësinë të shijojnë disa prej këtyre specialiteteve dhe ishin të mahnitur nga pamja dhe shija e ushqimit. Promovimi i ushqimit ka pasur karakter humanitar dhe mjetet ishin dhënë në Shtëpinë për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar në Berovë. Kjo broshurë ishte përgatitur në kuadër të iniciativës për projekt “Specialitete tradicionale të rajonit të Malishevës” i zbatuar nga Shoqata Qendër për Bimë dhe Fruta Mali “Ambrosia” në partneritet me Shoqatën Ekologjike “Solza”, të dy nga Pehçeva.





7

Zhvillohet Konferenca e parë kombëtare për ndryshimet klimatike dhe bujqësia maqedonase

Më 31 mars, në Strumicë, në bashkëpunim të projektit “Mbështetje institucionale të Federatës së Farmerëve të RM” We Effect – FFRM, projekti i USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe Ambasada e Mbretërisë së Suedisë, ishte organizuar e para Konferencë kombëtare në temën “Bujqësia maqedonase dhe ndryshimet klimatike”. Ngjarja kishte për qëllim të prezantojë efektet negativ të ndryshimeve klimatike mbi prodhimtarinë bujqësore para gjithë aktorëve dhe të prezantojë masa dhe teknika që do të ndihmojnë fermerëve të zvogëlojnë pasojat e dëmshme në kopshtari, pemtari, vreshtari dhe blegtori.

“Republika e Maqedonisë ende është në fillim të realizimit të qëllimeve

strategjike për adresim të ndryshimeve klimatike, ndërsa ata që më tepër varen nga këto vendime dhe zgjidhje janë prodhuesit bujqësorë dhe familjet rurale si përdorues të drejtpërdrejtë të tokës dhe resurseve natyrore. Ata janë grupi më i cenuar në këtë kontekst. Sfida në përballimin me ndryshimet klimatike është një proces i gjatë dhe kërkon mbështetje të madhe të vetëdijes publike dhe angazhim të përbashkët dhe bashkëpunim për të gjithë” – theksoi në drejtimin e tij Petar Gjorgievski, Kryetar i Rrjetit për Zhvillim Rural i RM, zbatues i projektit të USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike.

“Ndryshimet klimatike do të kenë ndikimin më negativ mbi bujqësinë. Për këtë, këto takime janë të mirë-





seardhur për neve fermerët, kryesisht sepse mund të mësohet dhe të shihen teknologji të reja për adaptimin e bujqësisë ndaj kushteve të reja të motit për të mbrojtur prodhimtarinë” – theksoi Nikolla Stamenov, kryetar i FFRM.

Profesorë të Institutit të Bujqësisë dhe Fakultetit të Shkencave Bujqësore dhe ushqim nga Shkupi kanë ndarë rezultatet dhe arritjet e zbatimit të masave të ndryshme adaptive në prodhimtarinë bujqësore, ndërsa para të pranishmëve u drejtuan edhe disa fermerë që kanë ndarë përvojat e tyre dhe shembujt pozitiv.

Ndryshimet klimatike janë realitet gjithkund në botë, dhe sipas analizave të ekspertëve, Maqedonia mund të pret ndryshime ekstreme në temperaturë, të cilat do të kenë pasoja të dëmshme mbi sektorin bujqësor. Pothuaj se gjysma e popullatës rurale në Maqedoni është ekonomikisht e varura nga bujqësia dhe ka nevojë urgjente për zbatimin e veprimeve të shpejta dhe metodave praktike adaptive.



Konkluzione nga konferenca e parë kombëtare “Bujqësia maqedonase dhe ndryshimet klimatike”:

1. Për shkak të ndikimeve negative të ndryshimeve klimatike siç janë: rritja e temperaturës së ajrit, intensitetit të rrezatimit të diellit, paraqitja e valëve të nxehtësisë, të reshura intensive, breshër si dhe mungesë të reshurave gjatë periudhës së vegetacionit të plotësuar me thatësi të gjatë, prodhuesit bujqësor në Republikën e Maqedonisë përballohen me sfida të madhe për trajnimin e këtyre ndryshimeve.
2. Sfida në përballimin me ndryshimet klimatike është një proces në të cilin prodhuesit bujqësor duhet të investojnë në kapacitetet e tyre për adaptim të bujqësisë ndaj kësaj dukurie por kjo gjithashtu kërkon edhe një mbështetje të madhe nga vetëdija publike dhe angazhim i përbashkët, bashkëpunim dhe koordinim të gjitha institucioneve relevante.
3. Ndryshimi i përhershëm dhe i vazhdueshëm në kuptim të zgjedhjes së kulturave të reja, teknologjive të reja dhe praktikave për menaxhim me prodhimtarinë bujqësore në pajtim me ndryshimet klimatike sjell nevojën e përfshirjes së ekspertizës shkencore-hulumtuese me çfarë do të garantohet realizimi i prodhimtarisë së qëndrueshme bujqësore.
4. Teknologjitë dhe njohuritë reja si dhe rritja e vetëdijes tek prodhuesit bujqësor në kuptim të masave adaptive për ndryshimet klimatike duhet të transmetohen me përfshirje aktive të shërbimeve këshillimore bujqësore si pjesë e praktikave të tyre të rregullta në dhënien e shërbimeve këshillimore për planifikim të suksesshëm dhe realizim të prodhimtarisë bujqësore.
5. Në të ardhmen, politika e bujqësisë dhe zhvillimit rural të RM-së duhet të lëviz drejt një politike që do të merr parasysh nevojën për adaptim të prodhimtarisë bujqësore dhe do të promovojë praktikat bujqësore që do të jenë kompatible me kushtet e reja klimatike dhe do të kontribuojnë në ruajtjen e resurseve natyrore.
6. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit duhet të bëjë vlerësim të nevojave të prodhuesve bujqësorë për mbështetje plotësuese për adaptim të bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike në sajë të masave për mbështetje me anë të programeve për zhvillim bujqësor dhe rural.
7. Duhet një koordinim mes institucioneve dhe organizatave të rajonit për qëllime të informimit me kohë, shkëmbim të përvojave dhe krijim ose miratim të masave të ngjashme të cilat do të rezultojnë me praktika të suksesshme në tejkalimin e efekteve negative nga ndryshimet klimatike. Me rëndësi është bashkëpunimi për krijimin e sistemit rajonal parandalues për ndryshimet klimatike.





8

Përgatitet video për adaptim të bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike

Ndryshimet klimatike kanë ndikim negativ mbi prodhimtarinë blegto-re. Nga vapa e verës gjedhet pësojnë stres nga ngrohja dhe duke u përshtatur ushqehet më pak dhe nga kjo zvogëlo-hen rezultatet prodhuese. Duke marrë parasysh faktin që prodhimtaria bleg-to-re kontribuon për të fituar produkte përfundimtare si qumësht, mish ose vezë, prej të cilëve do të arrihet fitim, pa dyshim është nevoja e zbatimit të masave për adaptim gjatë vapës verore kur temperaturat në fermat e tejkalon atë optimale për bagëtinë.

Rrjeti për Zhvillim Rural i Repub-

likës së Maqedonisë që zbaton projektin e USAID për adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike në bashkëpunim me profesorë të Fakultetit për Shkenca Bujqësore dhe Ushqim ka zbatuar masa adaptive që janë të lira dhe efikase në zvogëlimin e ndikimit negativ të ndryshimeve klimatike në blegtori.

Me qëllim të ndihmës së blegtorëve për të përballuar me ndikimin negativ nga ndryshimet klimatike, projekti ka përgatitur një video materiale në të cilën sqarohen masat e ndryshme për adaptim. Ky video material mund të gjendet

në kanalin Youtube të Rrjetit për Zhvillim Rural, në tre gjuhë: maqedonisht, anglisht dhe shqip.

Lidhjet:

Maqedonisht: <https://www.youtube.com/watch?v=5urKLVZ5xYs>

Anglist: <https://www.youtube.com/watch?v=6scQK6DVUr0&feature=share>

Shqip: <https://www.youtube.com/watch?v=ru833maszH4&feature=share>

9

Ngritja e vetëdijes publike për sëmundjen lëkurë me kokla tek lopët qumështore

Në kuadër të aktiviteteve të projektit të USAID për Adaptimi në Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, RZR ka nisur bashkëpunimin me Agjencinë për Ushqim dhe Veterinë për ngritjen e vetëdijes dhe kapacitetit të këshilltarëve të ANZHB-së dhe fermerëve blegtorë, në lidhje me gjendjen emergjente të sëmundjes me lëkurë me kokla tek lopët qumështore. Kjo sëmundje e rrjedh nga kontinenti afrikan dhe është transferuar me anë të vektorëve si mushkonja, rriqra, miza dhe është rezultat i drejtpërdrejtë i klimës që ndryshon. Për fat të keq, sëmundja është duke u shpërndarë me shpejtësi gjatë muajit dhe shumë blegtorë nga Maqedonia kanë humbur bagëtinë e tyre.

Për të informuar blegtorët dhe këshilltarët e ANZHB-së për simptomat dhe sëmundjen dhe të këshillohen për parandalimin e sëmundjes, projekt i USAID për ABNK, me mbështetjen e ekspertit të projektit për lopë qumështore Prof. Dr. Metodija Trajčev, kanë përgatitur fletushka informative dhe afishe për të shpërndarë palëve të interesuar. Këto materiale informative ishin shpërndarë pjesërisht me anë të punëtorive të organizuar gjatë qershorit për të edukuar blegtorët dhe këshilltarët e ANZHB-së për sëmundjen e lëkurës me kokla. Rreth 200 palë të interesuar kanë marrë pjesë në pesë punëtori të organizuar gjatë muajit në” Strumicë (3 qershor), Manastir (7 qershor), Gjevgjeli (8 qershor),





Koçanë (10 qershor) dhe Kavadar (14 qershor).

Gjatë kohës kur profesori i Fakultetit të Shkencave Bujqësore dhe Ushqim ka sqaruar veçoritë dhe simptomat e sëmundjes lëkurë me kokla dhe ka elaboruar për masat parandaluese në fermë që duhet të ndërmerren për të penguar përhapjen e sëmundjes, inspektorët nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës duke folur në aspekt të institucioneve qeveritare, kanë shkëmbyer informacione për masat e ndryshme parandaluese që ndërmerren në nivel kombëtar dhe kanë këshilluar blegtorët për të kërkuar vaksinim të kafshëve.

[illegible]

ШТО ПРЕСТАВУВА БОЛЕСТА ЈАЗЛЕСТА КОЖА КАЈ ГОВЕДАТА?

Болезта јазлеста кожа (Lumpy Skin Disease) кај говедата претставува вирусно заболување кое се манифестира со појава на треска, зголемена телесна температура, појава на јазли по кожата на телото, млечната жлезда, на лимфните и внатрешните органи, како и со отекување на кожата, а поврската и со утинување на заболениот животин.


Оваа болест има големо економско значење, затоа што значително ја намалува млечноста кај краватите, доведува до појавата на стерилитет кај бикотите и утинување на носии од заболениот животин.

Појавата на оваа болест била карактеристична за Јужна и Источна Африка до 1970 година, која се протирнала на северозапад од Африканскиот континент. Од 2003 година е регистрирана во некои земји на средниот исток. Во Европа прв пат е регистрирана во Турција во 2013 година, во Грција во 2015 година и Бугарија во 2016 година.

Денес оваа болест е присутна и во Република Македонија.

Ако се земе во предвид историјата на ширење на оваа болест на глобално ниво и ако се земе дека одне од главните вектори на преносување на болеста се комарците, тогаш е повеќе од очигледно влијанието на климатските промени врз појавата на болеста.





КОГА БИ ТРЕБАЛО ДА СЕ ПОСОМЕНИВАМ ДЕКА ВО ДОЛГАТА ФАРМА/ОДГЛЕДУВАЛИШТЕ СЕ ПОЈАВИЛА БОЛЕСТА ЈАЗЛЕСТА КОЖА И КОГА ЗА ТОА ТРЕБА ДА ГО ИНФОРМИРАМ МОЈОТ МАТИЧЕН ВЕТЕРИНАР ИЛИ АГРИМУМ ЗА ЗАХАНА И ВЕТИНАРСКО?

Доколку кај некое од животните во фармата/одгледувалиштето се забележат некои од следните промени:

- ▶ зголемување на телесната температура (до 42°C),
- ▶ појава на јазлести промени на кожата на телото и млечната жлезда (вимието),
- ▶ нагло намалување на млечноста,
- ▶ појава на исцедок од носот,
- ▶ абортус.

КАКО И НА КОЈ НАЧИН ЖИВОТНИТЕ ВО МОЈАТА ФАРМА/ОДГЛЕДУВАЛИШТЕ БИ МОЖЕЛЕ ДА СЕ РАЗБОЛАТ ОД БОЛЕСТА ЈАЗЛЕСТА КОЖА?

Животните од оваа болест може да се заразат на некој од следните начини:

- ▶ со убод од инсекти носители на применетиот кофод и циназ кри, како што се: комарците, штапските муши и кривоците,
- ▶ со директен контакт на здравно со заболено животно,
- ▶ преку храна, вода, млеко, опrema за млеко и други предмети и средства кои се користат во фармата/одгледувалиштето, а кои се контаминирани (исцеј во дојалото, заболени животни,
- ▶ преку нивна контакт преко бие во контакт со заболено животно.



ДАЛИ БОЛЕСТА ЈАЗЛЕСТА КОЖА ПРЕСТАВУВА ОПАСНОСТ ПО ЗДРАВЈЕТО НА ЛЈУДО?

Болезта јазлеста кожа не е опасна за луѓето, не се пренесува на луѓето од заболениот животин и екстремно ретко предизвикува одолго не претставува закана.





10

Publikohet video materiale për vetëdije publike për historitë e suksesit të projektit

Si rezultat i aktiviteteve të projektit të USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike për trajnimet në teren dhe zbatimin e masave adaptive për ndryshimet klimatike në fidanishte, një fermer i ri nga rajoni i Strumicës ka marrë vendimin që të organizojë fidanishten e tij të mollës me masat për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike të sugjeruara nga projekti. Me mbështetjen e këshilltarit të ANZHB i rajonit të Strumicës, ai ka aplikuar për mbështetje nga pro-

grami Kombëtar për Zhvillim Rural për fermerët e rinj dhe kishte marrë mbështetjen financiare për rreth € 10,000.00 (75% nga Qeveria, 25% nga fermeri) për blerjen edhe instalimin e rrjeteve UV, prerës dhe pajisje tjetër. Në maj, RZR ka vizituar fermerin dhe ka regjistruar deklaratën e tij dhe fidanishtet e mbuluar me rrjete UV. Kjo histori e suksesshme ishte pakëtuar në një video material në tre gjuhë (maqedonisht, shqip dhe anglisht) dhe ishte shpërndarë me fermerë tjerë me anë

të kanalit Youtube të RZR me synim të motivimit për të përshtatur prodhimtarinë e tyre ndaj ndryshimeve klimatike.

Lidhjet:

Maqedonisht: https://www.youtube.com/watch?v=m0nHEw_T1HQ

Anglisht: <https://www.youtube.com/watch?v=2F37h9QbGNQ>

Shqip: https://www.youtube.com/watch?v=pTeaBr7_YHc

11

Qasja EU LEADER i promovuar në Rajonin Lindor dhe Juglindor të Planifikimit të Republikës së Maqedonisë

Në janar, RZR ka organizuar një takim të përbashkët me Menaxherët e Rajoneve Lindore dhe Juglindore të Planifikimit dhe kanë diskutuar aktivitete e projektit të USAID Adaptimi Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike në lidhje me afirmimin e qasjes LEADER në dy rajonet. Ishin diskutuar situatat aktuale të rajoneve, komunave dhe aktorëve të secilit rajon për të zhvilluar një plan përkatës për ngritjen e kapa-



citeteve dhe orarin e zbatimit për aktorët.

Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve për përhapjen e mëtutjeshme të filo-

zosisë së qasjes LEADER në dy rajonet ka filluar më 18 shkurt, në Dojran. Në këtë ngjarje, para rreth 30 aktorëve nga Vallandova, Gjevgjelia, Bogdanci



LEADER qasjes në Dojran dhe Shtip, në mars, RZR ka filluar të organizojë punëtori për prezantime të hollësishme të metodologjisë LEADER dhe shtatë karakteristikat: strategjia e zhvillimit lokal e bazuar në qasjen territoriale; qasja “nga poshtë-lartë”; partneritet publik-privat: Grupe Lokale të Aksionit (GLA); aktivitete inovacioni; qasje shumë sektoriale; rrjetëzimi dhe zbatimi i projekteve për bashkëpunim. Gjatë marsit 2016, ishin organizuar 5 punëtori të ngjashme në: Gjevgjeli më 3 mars, në Shtip 14 mars, Koçanë më 15 mars, Bel Kamen afër Radovishit më 28 mars dhe sërish në Koçanë më 29 mars. Më tepër se 100 përfaqësues të vetëqeverisjes lokale, sektorit civil dhe afarist nga rajoni lindor dhe juglindor i planifikimit të Maqedonisë kanë marrë pjesë në këto punëtori që ishin planifikuar në sajë të komponentit për ngritje të kapacitetit për të përforcuar kapacitetet e aktorëve dhe rritjen e planifikimit të tyre pjesëmarrës në procesin e vendimmarrjes, të cilat janë të rëndësishme për komunitetin.





12

Zhvillohet Kuvendi i Parë Gjeneral i PREPARE AISBL

Më 11 qershor, në Bruksel, PREPARE Partneriteti për Evropë Rurale ka zhvilluar takimin e saj të rregullt si dhe Kuvendin e Parë Gjeneral të PREPARE si asociacion juridik i regjistruar ndërkombëtar dhe joprofitabil. Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë – RZR i RM, si partner i PREPARE, ishte e kyçur si një prej 14 organizatave që për momentin kanë anëtarësimin e plotë në PREPARE AISBL. Pas njoftimit për aktivitetet gjatë vitit 2015, ishin akorduar veprime të mëtejshme lidhur me Kuvendin vijues të PREPARE në 2016/Takimi shumë nacional tematik i projektit ALTER në shtator 2016 dhe Punëtorja në Rrugë nëpër vendet rreth Detit të Zi e parashikuar në tetor 2016. Përfaqësuesit e organizatave nga Shqipëria dhe Finlanda kanë ftuar partnerët tjerë të PREPARE në parlamentet e para rurale që planifikohen të organizohen në vendet e tyre



gjatë vitit të ardhshëm. Gjithashtu, në takim ishin diskutuar edhe aktivitetet vijuese në lidhje me Parlamentin Rural Evropian 2017.





13

Bashkëpunim me RBZR për zbatimin e projektit ALTER

(Territore Lokale Aktive për Zhvillim Ekonomik në Mjediset Rurale) financuar nga BE

Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë në mënyrë aktive ka bashkëpunuar me organizatat anëtare të RBZR – Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural (rrjetet për zhvillim rural të Kroacia, Serbisë, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Shqipëri) dhe një shoqëri qytetare nga Turqia, në përgatitjes për zbatimin e ALTER (Territore Lokale Aktive për Zhvillim

Ekonomik në Mjediset Rurale) projekt i financuar nga BE-ja. Ky aktivitet i përbashkët do të zbatohet në shtatë vende në vitin 2017, ka për qëllim të përforcojë kapacitetet e rrjeteve të organizatave qytetare, organizatat qytetare që janë anëtare të tyre si dhe organizatat tjera me çfarë do të kontribuohet për zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Në

kohën e njëjtë do të promovojnë partneritetin e tyre me institucionet publike dhe përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes dhe menaxhimit, për përmirësim të gjendjes së mjediseve rurale në këto vende. Aktivitetet kryesisht janë të përqendruar në rrjetëzim, ndërtim të kapaciteteve dhe përfaqësim.

14

Vizita e ELARD në Maqedoni

Më 26 dhe 27 maj, kryetari i LEADER Asociacionit Evropian për Zhvillim Rural – ELARD, z-nja Kristina Tamets, ka vizituar Maqedoninë bashkë me dy përfaqësues të Rrjetit Kombëtar për Zhvillim Rural të Estonisë dhe Ministrisë së Zhvillimit Rural të Estonisë. Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë – RZR i RM, si anëtare e ELARD prej vitit 2011, ka organizuar këtë vizitë dyditëshe me mbështetje të projektit të USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike.

Në debatin e organizuar më 26 maj në Shkup, ishin prezantuar përvojat e zbatimit të qasjes LEADER në vendet anëtare të BE-së dhe roli i ELARD në këto procese, si aleancë e më tepër se 1250 grupeve lokale të aksionit në 22 vende. Përfaqësuesit e Rrjetit Kombëtar Rural dhe Ministrisë për Zhvillim Rural të Estonisë kanë shkëmbyer përvojat e përfutur në procesin e zbatimit të LEADER në Estoni. Në debatin ka marrë pjesë edhe z-nja Biljana Kostovska, udhëheqëse e trupit për menaxhim me IPARD, nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomi të Ujit të R. së Maqedonisë, që ka pre-





zantuar aktivitetet lidhur me qasjen LEADER si pjesë e masave të reja të IPARD programit në periudhën e re të programimit 2014-2020. Kryetari i RZR i RM z. Petar Gjorgievski, para të pranishmëve ka prezantuar aktivitetet e deritanishme dhe mbështetjen nga Rrjeti për Zhvillim Rural në procesin e afirmimit të qasjes LEADER në Maqedoni dhe themelimi i iniciativave para-GLA.

Gjatë 26 dhe 27 maj, delegacioni i Estonisë ka vizituar iniciativat para-LAG në rajonin e Kumanovës – GLA “Aber 2015” dhe GLA “Zëri i fshatit” dhe në rajonin e Strumicës GLA “Belasica-Ograzhden” si dhe anëtarët e iniciativës GLA në rajonin e Gjevgjelisë, Valandovës dhe Bogdanci. Vizitorët kanë pasur mundësi të shohin një pjesë të pasurisë historike dhe natyrale të rajoneve, si zhvillim potencial të inicia-

tivave të mëtutjeshme. Gjithashtu, në Kumanovë, ishte organizuar vizitë e “Eko Grin Pulp” – fabrika për reciklin të letrës dhe prodhim të tablove – pakove për vezë, që është anëtare e GLA “Aber 2015” si përfaqësues i sektorit afarist. Një shembull tjetër i iniciativave lokale ishte “fushata lokale për përballim me ndryshimet klimatike” e zbatuar nga OJQ “Planetum” dhe “Festivalin e Fiqve të Egra” të zbatuar nga OJQ “Slou Fud Ograzhden”, të dy të organizuar nga anëtare të para-GLA Belasica-Ograzhden. Të fituarit ishin mahnitur nga ujëvarat Gabrove në të cilën rrethina ishte rregulluar në kuadër të projektit të përbashkët të Qendrës për Zhvillim të Rajonit Juglindor të Planifikimit dhe Strumicës.

Takimet e realizuar në kuadër të vizitës dyditore kanë krijuar mundësi për bashkëpunim të mëtutjeshëm në drejtim të përforcimit të kapaciteteve të aktorëve të këtyre iniciativave para-GLA me anë të transferimit të njohurisë dhe përvojës lidhur me procesin e zbatimit të qasjes LEADER.





15

ELARD kremton presidencën e re për periudhën 2016-2017

Qytetarja estoniane Kristiina Tammets është zgjedhur femra e parë presidenciale e ELARD (Asociacioni Evropian LEADER për Zhvillim Rural)

Më 16 dhe 17 shkurt, ishte zhvilluar Asambleja e 11 e Përgjithshme e ELARD në Bruksel, që kishte për qëllim të përmbledhë presidencën çeke dhe të prezantojë qëllimet dhe planin e veprimit të presidencës Estoneze për 2016-2017.

Përfaqësuesi i Sindikatës Udhëheqëse të Estonisë, Kristiina Tammets (menaxhere e GLA Shoqata për Zhvillim Rural Tartu) ishte zgjedhur presidenti i ri i asociacionit, ndërsa Pedro Brosei nga Portugalia dhe Radim Sršen nga Republika Çeke ishin zgjedhur për nënkryetarët e rinj. Kristiina Tammets është presidentja e parë femër në historinë e pothuajse njëzetvjeçare të ELARD.

Sipas Kristiina Tammets, udhëheqësia e ELARD është punë ekipore, dhe kryesore është të arrihen pritjet e anëtarëve, që përfaqësojnë nevojat dhe interesat e popullit në rajonet rurale nëpër gjithë Evropën.



ELARD është asociacion ndërkombëtar jo-profitabile e themeluar për të siguruar një zhvillim të baraspeshuar dhe të qëndrueshme të rajoneve rurale. Asociacioni evropian LEADER bashkon më tepër 1250 grupe lokale të aksionit nga 22 vende (Republika Çeke, Kroacia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Latvia, Lituania, Polonia, Portugalia, Rumania, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Mbretëria e Bashkuar, Bosnja dhe Hercegovina).

Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë është pjesë e ELARD që prej vitit 2011.

